

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE




NEWSLETTER

Mars, 2018.

Nr. 03/2018

Promovohen spotet e televizionit dhe radios kundër seksizmit në medime dhe hulumtimet mbi gjininë në programet televizive gjatë vitit 2017



Me qëllim që të kthehet vëmendja e medimeve ndaj njohjes së rëndësisë së informimit për çështjet gjinore, si dhe të nxitet tejkalimi i stereotipeve gjinore, Agjencia sot i prezantoi rezultatet e hulumtimit për gjininë në programet televizive gjatë vitit 2017 dhe i promovoi spotet e televizionit dhe radios kundër seksizmit në medime. Hulumtimi lidhur me përfaqësimin e gjinisë në programet televizive përbëhet prej dy analizave – njëra për çështjet gjinore në konceptet dhe përmbajtjet programore të emisioneve të informimit ditor, të televizioneve në nivel nacional, kurse tjetra për mënyrën e prezantimit dhe pasqyrit të grave dhe burrave në reklama.

Në kuadër të fushatës mediatike “Seksizmit nënçmon” u prezantuan dy spote televizive dhe një për radio, që kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes së publikut edhe te punëtorët mediatik për rëndësinë e barazisë gjinore dhe tejkalimit të paragjyimeve dhe stereotipeve gjinore. Duke marrë parasysh se bëhet fjalë për fushatë me interes publik, Agjencia pret që medimet t'i emetojnë falas në programet e tyre.

Promovohet Deklarata për informim etik dhe profesional për temat në lidhje me bashkësinë LGBTI



Në kuadër të përpjekjes për informim profesional për bashkësinë LGBTI si dhe për respektimin e të drejtave të tyre pa fjalim diskriminues dhe dërrigues, sot u promovua Deklarata për informim etik dhe profesional për temat në lidhje me LGBTI.

Iniciator për këtë dokument ishin Koalicioni Margini, Këshilli për etikë në medime, Shoqata e Gazetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.


Deklarata si akt formal duhet të kontribuojë për parandalimin e gjuhës stigmatizuese ndaj kësaj grupe, në medime dhe promovimin e dallimeve seksuale dhe gjinore, përfshirë edhe mbrojtjen e të drejtave të bashkësisë LGBTI. Parimet që janë përfshirë me Deklaratën kanë të bëjnë me përmbajtje dhe dënim të gjuhës së urrejtjes në bazë të orientimit seksual, identitetit gjinore ose cilës do përkatësi të grupeve të marginalizuara

Maqedonia në emrin e vendeve të Ballkanit perëndimor mori pjesë në ERGA



Përfaqësuesit e Grupit të rregullatorëve evropian për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (ERGA) dhe sot në Zagreb biseduan për ballafaqimin me vallët e lajmeve të rrejshme si dhe për rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe më gjërë, në drejtim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira. Për herë të parë në takimin e ERGA-s mori pjesë edhe eurokomisari për ekonomi digjitale dhe shoqëri, në kompetencën e të cilit janë edhe medimet. Eurokomisarja Marija Gabriell theksoi domosdoshmërinë e vendeve të Ballkanit Perëndimor që në kuadër të aspiratave të tyre eurointegruese të qasen drejt harmonizimit të legjislativës së tyre në fushën audiovizuale me direktivat Evropiane për shërbime mediatike audiovizuale. Ajo theksoi se dobi më të madhe do të kenë shikuesit dhe dëgjuesit, ndërsa njëkohësisht do të kontribohet për nxitjen e konkurrencës në sferën mediatike.

Në takim, për herë të parë u dëgjuan edhe qëndrimet e rregullatorëve nga Ballkani perëndimor. Në emrin e tyre, drejtori i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Zoran Trajčevski, theksoi se lajmet dhe informatat nuk njohin barriera fizike, për çka edhe është me rëndësi bashkëpunimi bilateral dhe rajonal si dhe për nxitjen e diskutimeve për çështje të rëndësishme të rregullimit.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

U realizua takimi i parë publik për vitin 2018



Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale sot realizoi takimin e parë publik për vitin 2018. Lidhur me aktivitetet e realizuara sipas Planit vjetor të punës, fjalë kishte d-r Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë, i cili i prezantoi aktivitetet e realizuara gjatë tremujorit të kaluar – mbikëqyrjet e radiodifuzerëve, operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik si dhe publikuesit e medieve të shtypit; masat e shqiptuara; hulumtimet e bëra; aktivitetet në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar si dhe aktivitete tjera.

Në këtë takim u promovuan edhe publikimet që i botoi Agjencia, e që kanë të bëjnë me çështjet gjinore në programet televizive. Të tri publikimet përmbledhëse me hulumtimet vjetore që flasin për praninë dhe prezantimin e gjinisë në programet e televizioneve nacionale, në periudhën 2012-2016, janë botuar në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze. Publikimet përmbajnë pesë hulumtime dhe një meta-analizë e cila i tregon trendet në aspekt të gjinisë dhe medimeve. Në këtë ngjarje u promovua edhe publikimi për gjininë në programet televizive gjatë vitit 2017, e cila përbëhet nga dy analiza prej të cilave njëra tregon nëse, sa dhe në çfarë mënyre janë të pranishme çështjet gjinore, kurse tjetra e jep pasqyrën për mënyrën se si janë prezantuar dhe pasqyruar gjinitë në program. Analizat në këtë publikim, gjithashtu, janë në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze



Të pranishmit kishin mundësi që të përcjellin edhe konstatimet e hulumtimit të mendimit të publikut për programet e radios dhe televizionit në Republikën e Maqedonisë, të realizuar në periudhën nëntor-dhjetor 2017. Hulumtimi përmban të dhëna për qëndrimet e publikut dhe për përfaqësimin e kualitetit të përmbajtjeve të caktuara programore të shërbimeve të televizioneve dhe radiostacioneve vendase, shkallës së plotsueshmërisë së ofertës programore, mënyrës se si publiku i shfrytëzon mediumet, përmbajtjet më të shikuara/dëgjuara programore. Hulumtimi ofron të dhëna edhe për pjesëmarrjen dhe prezantimin e të rinjve në medime dhe përfaqësimin e personave me orientim të ndryshëm seksual.


Takim bilateral ndërmjet trupave rregullues të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë në Tiranë



Një delegacion i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale si dhe përfaqësues të trupit rregullues të meimeve të Republikës së Shqipërisë (AMA), sot në Tiranë, u dakorduan për thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë si dhe rritjen e shkëmbimit të përvojave në sferën e rregullimit mediatik.

Në takimin bilateral, u bisedua për përvojat në lidhje me procesin e digjitalizimit të televizioneve, monitorimin e përmbajtjeve mediatike, të drejtat autoriale, reklamimin, si dhe zhvillimin e medimeve dhe inovacioneve teknologjike në këtë drejtim. Në kuadër të takimit, u realizua edhe një vizitë e televizionit nacional të Shqipërisë Top Çanel.

Të dy palët konstatuan se ka hapsirë për përparimin e marrëdhënieve bilaterale, posaçërisht në drejtim të çështjeve me interes të përbashkët dhe në këtë drejtim shprehën gëdhëmi për nënshkrimin e një memorandumit për bashkëpunim në të ardhmen.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



NEWSLETTER

Njoftime për publik nga Agjencia

Në mars, dy herë bëri reagime publike, në aspekt të sulmit verbal dhe pengimit të punës së medimeve. Njëra ishte në lidhje me kërcënimet ndaj Kryetarit të SHGM, Naser Selmani, kurse tjetra pas informatës së TV 21 se një gazetar i tyre ka qenë i penguar për të parashtruar pyetje në konferencë për shtyp të organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Përmes deklaratës për publik, u demantuan edhe kosntatimet e ministrit Robert Popovski, të theksuara në debatin publik të realizuar më 2 mars 2018 në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, se Agjencia me vite nuk ka funksionuar dhe se nuk i ka kryer kompetencat e saja, në kontekst të rritjes së shërbimeve programore pa të drejta autoriale.

Agjencia ju bashkangjit iniciativës së Qeverisë së RM për transparencë ndaj shpenzimeve të bartësve të funksioneve publike dhe në këtë drejtim i publikoi shpenzimet e drejtorit për gjysëmvetorin e dytë të vitit 2017.

Mbikëqyrja ndaj radiodifuzerëve

Agjencia realizoi një mbikëqyre të rregullt programore ndaj shërbimeve programore të Radios së Maqedonisë RAM1, RAM 2 dhe RAM 3 që kanë të bëjnë me rregullat për: transmetimi i komunikimeve komerciale; dhënien e kuicave ose formave të tjera të shpërblimit të pjesëmarrjes; përdorimi i shërbimeve me vlerë të shtuar telefonike dhe zëri i telefonit; transmetimi i lojërave të fatit; kohëzgjatja e transmetimeve ditore dhe detyrimet për muzikë dhe programet e krijuara fillimisht. Shkeljet nuk janë krijuar me mbikëqyrjen. Për të njëjtat shërbime programore, u zbatua mbikëqyrja e rregullt administrative e detyrimeve që lidhen me impresumin, informatat në dispozicion të përdoruesve dhe identifikimi i një transmetuesi. Shkelja është vërejtur vetëm në programin e RAM 1.


Me mbikëqyrjen e jashtëzakonshme të realizuar me detyrë zyrtare ndaj emisionit "Milenko Nedelkovski shou" të emetuar në TV Alfa, më 27 janar 2018, Agjencia konstatoi se në këtë edicion janë shprehur disa deklarata dhe qëndrime me të cilat nxitet dhe përhapet diskriminimi, mosdurimi dhe urrejtja në bazë të përkatësisë etnike. duke marrë parasysh se në Ligj nuk është paraparë masë për këtë shkelje, Agjencia do të dorëzojë incizimet dhe Raportin e shkruar nga mbikëqyrja programore deri te Prokuroria publike themelore Shkup si dhe deri te Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, për procedura të mëtejshme. Është kryer një monitorim i jashtëzakonshëm i programit të emisionit "Samo vistina", transmetuar më 28 shkurt 2018 në TV Kanal 5 dhe është vërtetuar se stereotipet dhe paragjykimet në bazë të gjinisë, veçanërisht lidhur me gratë dhe statusin e tyre martesor, janë paraqitur në program është një shkelje e parimit të bërjes së biznesit në pjesën që lidhet me liritë dhe të drejtat, pavarësisht nga gjinia. Për këtë shkelje, Agjencia e TV Kanal 5 paraqiti një vërejtje me shkrim.

Mbikëqyrjet ndaj operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Agjencia realizoi një mbikëqyrje programore ndaj operatorëve kabllor KDS-KABEL NET, SPAJDER-NET, MULTIMEDIJA-NET, KABEL, Telekom i Maqedonisë, ROBI dhe SKUPI KABLE, në lidhje me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me obligimet për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci dhe për titrimin në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e bashkësisë joshumicë në RM. Te këto operatorë nuk janë konstatuar shkelje.

Mbikëqyrja ndaj medieve të shtypit

Mbikëqyrje e jashtë zakonshme administrative është realizuar ndaj magazinave mujore "Jeni Balkan"; "Isprati recept"; "Story", magazinat në gjuhën shqipe "Mini Libi" dhe "Libi", si dhe gazetën javore në gjuhën turke Jeni Balkan Haftalık Bilten, në lidhje me obligimet për publikimin e të dhënave për selinë, redaksinë, shtypshkronjën, tirazhin dhe datën e botimit ose ribotimit. Mbikëqyrja tregoi se e kanë plotësuar obligimin nga Ligji për medime.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

rr. Maqedonia nr. 38, 1000 Shkup

Tel. (02) 3103400 faks: (02) 3103401

e-posta: contact@avmu.mk ueb faqja: www.avmu.mk

